




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation*

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General
Secretary

Nr. 2/2761
Dt. 20-09-2024

Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 45 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, nxjerr:

V E N D I M

Për miratimin e listës së përzgjedhur nga Këshilli Shkencor i MASHTI-t për përfituesit e projekteve të vogla shkencore 2024

1. Miratohet lista e përzgjedhur e Këshillit Shkencor (KSH) të MASHTI-t për përfituesit e projekteve të vogla shkencore 2024, të aprovuara për financim, si më poshtë:

1.1. Projekti i prof. Besnik Morina me titull “*Dallimet në përhapjen e mbipeshës dhe obezitetit si dhe nivelit të aftësive motorike te nxënësit e shkollave fillore, të zonave urbane dhe rurale të Republikës së Kosovës*” nga Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, KSH i MASHTI e aprovon për financim nga MASHTI në vlerë prej 8.800,00euro.

1.2. Projekti i prof. Izet Ibrahimimi me titull “*Riciklimi i mbetjeve ferore sipas qasjes së re “SNACK”, mundësi e një progresi teknologjik dhe tranzicionit të industrisë metalurgjike dhe zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë*” nga Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë, KSH i MASHTI e aprovon për financim nga MASHTI në vlerë prej 8.000,00euro.

1.3. Projekti i prof. Afrim Osmani me titull “*Hulumtimi dhe zhvillimi i reaksioneve të metaleve nëpërmjet analizës termike INSITU*”, nga Fakulteti i Gjeoshkencave, Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë, KSH i MASHTI e aprovon për financim nga MASHTI në vlerë prej 8.000,00euro.

1.4. Projekti i prof. Bahtir Hysenit me titull “Kokrrat e kafesë 2.0: Siguria ushqimore dhe përmirësimi i cilësisë dhe parametrave shqisor të kafesë me fermentim” nga Fakulteti i Teknologjisë ushqimore, Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë, KSH i MASHTI e aprovon për financim nga MASHTI në vlerë prej 8.000,00 euro.

2. Të përmendurve në pikën 1 të këtij Vendimi, u bëhet pagesa e projekteve në shumën totale të projektit të përfunduar.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, kërkesës nga Departamenti i Arsimit të Lartë dhe Shkencës në MASHTI me nr.2067 të dt. 17.09.2024, procesverbalin e mbledhjes së KSH të MASHTI të datës 10.09.2024, u vendos në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Të lartpërmendurve;
2. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
3. DALSHT/MASHTI;
4. Arkivit të MASHTI.

